

**AKTMARRËVESHJE**

MIDIS

**QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

DHE

**BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE  
ZHVILLIM**

NË LIDHJE ME

**BASHKËPUNIMIN NË MBËSHTETJE TË KLIMËS SË  
INVESTIMEVE DHE QEVERISJES SË MIRË**

**24 SHKURT 2014**

**AKTMARRËSHJE** midis Qeverisë së Shqipërisë (më tej e quajtur këtu “**Qeveria**”) dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (më tej e quajtur këtu “**BERZH**”), më tej veçmas të quajtura këtu “**Palë**” dhe bashkërisht të quajtura “**Palët**”.

**DUKE QENË SE BERZH-i** ka prezantuar Nismën për Klimën e Investimeve dhe Qeverisjen e Mirë (“**ICGGI**”) për të rigjallëruar tranzicionin ekonomik në një sërë vendesh ku ka operacione, përfshirë edhe Shqipërinë;

**DUKE QENË SE** në kuadër të ICGGI-së, BERZH-i ka parashikuar një varg instrumentesh të cilat kërkojnë ta përmirësojnë dialogun midis sektorit privat dhe qeverisë me qëllim përmirësimin e klimës së investimeve, për të fuqizuar kuadrin ligjor dhe mekanizmat e zgjidhjes së fmosmarrëveshjeve, për të ulur informalitetin dhe për të rritur transparencën në sektorët e shoqërive tregtare dhe bankave;

**DUKE QENË SE** Qeveria ka ngritur Këshillin Ekonomik Kombëtar me kompetenca të gjera për analizimin dhe diskutimin e reformave politike të lidhura me ecurinë ekonomike dhe investimet e huaja dhe vendase; dhe

**DUKE QENË SE** Qeveria ka premtuar të punojë me institucionet ndërkombëtare për të zgjidhur problemet e korruptionit, informalitetit në ekonomi dhe dobësive në klimën e biznesit;

**DUKE QENË SE BERZH-i** dhe Qeveria kanë nënshkruar më 20 nëntor 2013 një Letër-synimi me qëllim eksplorimin bashkërisht të mundësive për të bashkëpunuar për përmirësimin e klimës së investimeve dhe nxitjes së qeverisjes së mirë në Shqipëri, në përputhje me qëllimet dhe funksionet e BERZH-it dhe me prioritetet e deklaruara për reformat të Qeverisë.

Palët janë marrë vesh si më poshtë:

## I. QËLLIMI

Kjo Aktmarrëveshje synon të parashikojë një kuadër bashkëpunimi midis BERZH-it dhe Qeverisë në mbështetje të Këshillit Ekonomik Kombëtar (“**KEK**”) dhe në përputhje me objektivat e ICGGI-së, me qëllim përmirësimin e zhvillimit të sektorit privat, fuqizimin e klimës së biznesit dhe investimeve dhe nxitjen e qeverisjes së mirë.

## II. BASHKËPUNIMI

### 1. Rol i Qeverisë

Qeveria, brenda fushës së kompetencës dhe në përputhje me legjisacionin e Republikës së Shqipërisë, synon:

- të identifikojë fushat në të cilat veprimet e Qeverisë dhe asistenca e BERZH-it mund të ketë si rezultat një përmirësim të konsiderueshmët në zhvillimin e sektorit privat dhe në klimën e biznesit dhe investimeve në Shqipëri;
- të promovojojë aktivitet e parashikuara në bazë të kësaj Aktmarrëveshjeje, duke përfshirë, ndër të tjera, punën e një këshilli të përkushtuar për investimet në mbështetje të KEK-së dhe Sekretariatit të KEK-së (sikurse parashikohet në Shtojcën 1 të kësaj Aktmarrëveshjeje), të vëré në zbatim masat e propozuara nga komuniteti i biznesit dhe të vendosura në mbledhjet e Këshillit për Investimet, dhe të udhëheqë punën për të fuqizuar shtetin ligjor, për të parandaluar korruptionin, për të përforcuar mekanizmat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, për të rritur transparencën dhe për të trajtuar çështjen e informalitetit në ekonomi;
- të punojë nga afér me BERZH-in, dhe palë të tjera të interesit, për analizën e përbashkët dhe përcaktimin e rrugëve të mundshme për të përmirësuar legislacionin, praktikat dhe fushat e tjera të lidhura me synim nxitjen e investimeve, si të huaja edhe të brendshme, në ekonominë Shqipërisë;
- të marrë masat e nevojshme për të identifikuar dhe çelur mundësítë për të thithur investimet e huaja dhe galvanizuar investimet e brendshme drejt sektorëve me potencial për të zhvilluar dhe kontribuar në rritjen ekonomike.

## **2. Roli i BERZH-it**

BERZH-i, në përputhje me Strategjinë për Shqipërinë, me ndryshimet përkatëse që i bën herë pas here Këshilli i Administrimit i BERZH-it, në përputhje me ICGGI-në dhe me rregullloret e tjera të brendshme të saj, synon ta mbështetë, sipas rastit, vënien në zbatim nga Qeveria të strategjisë së saj kundër korruptionit, si edhe përpjekjet e Qeverisë që synojnë në rritjen e investimeve dhe në përmirësimin e zhvillimit të sektorit privat dhe të klimës së biznesit në përgjithësi në Shqipëri. Në veçanti, BERZH-i synon:

- ta mbështetë Qeverinë në punën e saj për ngritjen e Këshillit për Investimet i cili do japë llogari përpara KEK-së dhe Sekretariatit të KEK-së dhe do t'i mbështetë KEK-në dhe Sekretariatin e KEK-së, duke përfshirë edhe përmes kërkimit të fondeve nga donatorët të cilat do t'i vihen në dispozicion Qeverisë përmes BERZH-it për të financiar sekretariatin e Këshillit për Investimet, përmes marrjes pjesë aktivisht në punën e Këshillit për Investimet dhe përmes mbështetjes dhe mbikëqyrjes së funksionimit të Sekretariatit;
- t'i rrisë më tej përpjekjet për ta fuqizuar shtetin ligjor dhe funksionimin e gjyqësorit përmes ngritjes së institucioneve dhe trajnimit gjyqësor;
- të hetojë praktikën më të mirë dhe të ofrojë këshilla dhe rekomandime se si të përmirësohet funksionimi i zyrës së regjistrimit të bizneseve në Shqipëri (Qendra Kombëtare e Regjistrimit), si një prej elementeve bazë të punës për uljen e nivelit të informalitetit në ekonomi;
- të mobilizojë asistencë teknike për ta ndihmuar Qeverinë për projektimin dhe vënien në zbatim të një regjistri të efektshëm për kreditnë konsumatore, duke u mbështetur në institucionet ekzistuese dhe duke i fuqizuar kapacitetet e tyre për të përfshirë të dhëna për individë dhe institucione jofinanciare siç janë ato të ndërmarrjeve të shërbimeve publike;
- të punojë nga afér me Qeverinë për të përcaktuar fushat ku BERZH-i mund të përdorë përvojën e saj dhe njojuritë e saj prej eksperti për të mbështetur përpjekjet e Qeverisë për të nxitur zhvillimin e sektorit privat dhe të klimës së

- biznesit në përgjithësi në Shqipëri, për shembull përmes promovimit të drejtimit të mirë të brendshëm të shoqërive tregtare dhe të transparencës në sektorin e shoqërive tregtare dhe bankave, duke punuar nga afërt me komunitetin e bankave, shoqatat e biznesit dhe Bankën e Shqipërisë;
- të ngrejë një kuadër monitorues, në bashkëpunim të ngushtë me shoqërinë civile dhe institucionet e tjera përkatëse, pér të ndjekur vënien në zbatim dhe pér të matur rezultatet e ndërhyrjeve të lidhura me ICGGI-në.

### **III. DISPOZITA TË FUNDIT**

Kjo Aktmarrëveshje pasqyron pikëpamjet dhe synimet e Palëve pér të bashkëpunuar në mënyrë jo përjashtuese, të shprehura në mirëbesim por pa krijuar asnje detyrim ligjor apo përgjegjësi pér asnjëren prej tyre. Nga kjo Aktmarrëveshje nuk nxjerr asnje avantazh ligjor asnje i tretë.

Palët janë marrë vesh dhe kanë rënë dakord se asnje parashikim i kësaj Aktmarrëveshjeje nuk mund të përbëjë e as nuk mund të interpretohet si premtim apo sipërmarrje e njërsës Palë pér të financuar tërësisht ose pjesërisht një aktivitet apo projekt të identifikuar në këtë Aktmarrëveshje apo sipas kësaj Marrëveshjeje.

Asnjë parashikim i kësaj Marrëveshjeje nuk e kufizon të drejtën e Palëve e nuk i pengon ato të bëjnë akte apo rregullime me palë të tjera në lidhje me aktivitete, projekte apo fusha të tjera bashkëpunimi që mbulon kjo Aktmarrëveshje.


Asnjë parashikim në këtë Aktmarrëveshje nuk përbën e as nuk interpretohet si heqje dorë, mospërdorim apo modifikim i asnjë privilegji, imuniteti apo përjashtimi që i është dhënë BERZH-it në kuadër të Marrëveshjes themeluese të Bankës Evropiane pér Rindërtim dhe Zhvillim, të konvantave ndërkombëtare apo të legjisacionit të zbatueshëm.

Çdo mosmarrëveshje që lind pér pasojë ose në lidhje me interpretimin apo zbatimin e ndonjërit të parashikimeve të kësaj Aktmarrëveshjeje do të zgjidhet në mënyrë miqësore përmes konsultimeve.

Kjo Aktmarrëveshje hyn në fuqi datën e nënshkrimit nga të dyja Palët. Ajo mund të ndryshohet me pëlqimin reciprok të Palëve, të shprehur me shkrim. Afati i vlefshmërisë së kësaj Aktmarrëveshjeje është pesë vjet, kohë pas së cilës mund të rishikohet dhe zgjatet me pëlqimin reciprok të Palëve. Aktivitetet e parashikuara në këtë Aktmarrëveshje do të vihen në zbatim gradualisht me kalimin e kohës, duke filluar me ngritjen e Këshillit pér Investimet. Çdo vit do të bëhet një shqyrtime periodik i vënies në zbatim të masave të parashikuara në bazë të kësaj Aktmarrëveshjeje. Secila palë mund ta ndërpresë këtë Aktmarrëveshje në çdo kohë, duke i dhënë Palës tjeter njoftim me shkrim pér këtë qëllim jo më vonë se një muaj përpëra datës së ndërpertjes.


Nënshkruar në Londër më 24 shkurt 2014, në dy kopje origjinale në gjuhën angleze dhe dy kopje origjinale në gjuhën shqipe. Në rast konflikti mes dy versioneve gjuhësore, epërsi ka versioni në gjuhën angleze.

**Për Qeverinë:**



Emri: SH.T. Edi Rama  
Titulli: Kryeministri

**Për Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim:**



\_\_\_\_\_  
Emri: Suma Chakrabarti  
Titulli: Presidenti

## SHTOJCA 1. KONCEPTI I KËSHILLIT PËR INVESTIMET

### 1. Mandati

Mandati i Këshillit për Investimet është mirë të përcaktohet me një vendim qeverie.

Këshilli për Investimet të ngrihet në vartësi të Këshillit Ekonomik Kombëtar dhe nën autoritetin e Kryeministrat të Republikës së Shqipërisë, për të vepruar si organ këshillimor me misionin e drejtimit të dialogut midis përfaqësuesve të komunitetit të biznesit dhe Qeverisë, në përpjekje për të zhvilluar një mjedis biznesi të favorshëm, mosdiskriminues, transparent dhe të favorshëm për investimet.

### 2. Funksionet kryesore

Këshilli për Investimet ngrihet si një platformë gjithëpërfshirëse për dialogun e nivelit të lartë mes Qeverisë, donatorëve/institucioneve financiare ndërkombëtare dhe komunitetit të biznesit, me qëllim:

- nxitjen e dialogut konstruktiv dhe arritjen e konsensusit për hapat e nevojshëm mes Qeverisë dhe sektorit privat për t'u dhënë zgjidhje çështjeve më urgjente për zhvillimin e sektorit privat dhe përmirësimin e klimës së biznesit në përgjithësi dhe nxitjen e investimeve vendase dhe të huaja;
- identifikimin e pengesave kryesore në mjedisin e biznesit në sektorë të ndryshëm të ekonomisë dhe hartimin e strategjive të ndërhyrjeve për të arritur efektin maksimal;
- identifikimin e pengesave kryesore ndaj investimeve të huaja të drejtpërdrejta dhe ngritjen e një platforme me objektivat, stimujt dhe mekanizmat e nevojshme për të thithur në vend investime cilësore;
- zhvillimin e metodave që ndihmojnë mundësitë e marrjes së financimeve si për investitorët vendas ashtu edhe për ata të huaj;
- shqyrtimin dhe vlerësimin e projekt-legjislacionit që prekin biznesin dhe propozimin e ndryshimeve përkatëse në kuadrin legjislativ ose rregullator për t'u dhënë zgjidhje pengesave ndaj celjes, shfrytëzimit, rritjes apo mbylljes së biznesit;
- shqyrtimin, hetimin dhe raportimin e rasteve të trajtimit të pandershëm dhe praktikave abuzive ndaj biznesit, në mënyrë që të ndihmohen procedurat e lidhura me biznesin;
- zhvillimin e praktikave më të mira në parandalimin dhe luftimin e korruptionit, duke qenë se prek biznesin privat, krahas mbështetjes së hartimit të aspekteve përkatëse të Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Korruptionit si një piketë e rëndësishme në këtë fushë;
- promovimin e dialogut në luftën kundër informalitetit, krahas shqyrtimit dhe zbatimit të praktikave më të mira për zvogëlimin e fushave informale të ekonomisë;
- mundësimin e shkëmbimit të përvojës dhe praktikave më të mira nga vendet e tjera në lidhje me procesin e nxitjes së reformës rregullatore.

Këshilli për Investimet nuk ka tagër vendimmarrjeje në vetvete, por në bazë të diskutimeve dhe propozimeve të anëtarëve të Këshillit për Investimet, Kryeministri do të marrë vendime, do t'u japë institucioneve të linjës indikacione dhe do të marrë

nismën për të hartuar akte normative që kanë për qëllim përmirësimin e zhvillimit të sektorit privat dhe të mjedisit të biznesit në përgjithësi.

Këshilli për Investimet nuk ka si synim të zëvendësojë aktivitetin e asnjë institucioni a ministrie, por të jetë një platformë e bashkërendimit dhe vendosjes së prioriteteve për politikat që zbaton në fushën ekonomike Shteti, si edhe të monitorojet efektivitetin e aktivitetit të tyre.

### **3. Anëtarët**

Këshilli për Investimet përbëhet nga jo më shumë se 10-15 anëtarë, duke bashkuar në një vend disa grupe pjesëmarrësish (palësh interesit):

- Institucionet shtetërore, për shembull ministritë e linjës, Bankën Qendrore;
- Përfaqësues të shoqatave të bankave/bizneseve vendase dhe të huaja;
- Përfaqësues të donatorëve dhe institucioneve financiare ndërkombëtare që janë aktive në fushën e zhvillimit të sektorit privat.

Përbërja e Këshillit për Investimet aprovohet nga Kryeministri. Rolin e Kryetarit të Këshillit për Investimet e përmblidhet një zyrtar i lartë i Qeverisë.

Krahas anëtarëve të përhershëm, në varësi të rendit të ditës dhe temave/sektorëve për t'u diskutuar nga Këshilli për Investimet, në aktivitetin e këtij të fundit mund të angazhohen edhe ekspertë, shoqata të sektorit, institucione të specializuara shtetërore, përfaqësues të komunitetit të biznesit, etj.

### **4. Sekretariati**

Aktivitetin rutinë të Këshillit për Investimet e bashkërendon Sekretariati i Këshillit për Investimet, i mbështetur nga BERZH-i. Sekretariati nuk duhet të ketë përkatësi politike. Shefi dhe anëtarët e Sekretariatit nuk mund të janë anëtarë të asnjë partie apo organizate politike.

Sekretariati i Këshillit për Investimet, gjatë mbështetjes së aktiviteteve të lidhura me Këshillin Ekonomik Kombëtar dhe Sekretariat të atij Këshilli:

- Përgatit rendin e ditës për mbledhjet e Këshillit për Investimet, duke u mbështetur, sipas rastit, tek propozimet e anëtarëve dhe duke marrë miratimin e Kryeministrat;
- Bashkërendon aktivitetin e Këshillit për Investimet, duke përfshirë përgatitjen e mbledhjeve, hartimin e propozimeve për ndërhyrjet, konsultimin me komunitetin e biznesit, marjen e ankesave nga bizneset dhe raportimin për to; ofrimin e seancave të trajnimit teknik;
- I jep Kryeministrat dhe anëtarëve të Këshillit një përbledhje të pikëpamjeve dhe rekomandimeve për temat në rendin e ditës së Këshillit për Investimet, në mënyrë që të sigurohet një cilësi e lartë e vendimeve të marra në Këshill;
- Drejtton procesin e vënies në zbatim të vendimeve të Këshillit të Investimeve, monitoron/vlerëson rezultatet dhe vlerëson ndikimin dhe efektivitetin e tyre në mjedisin e biznesit;

- Raporton përpara anëtarëve të Këshillit për Investimet dhe Kryeministrat lidhur me progresin e arritur;
- Mban lidhje të ngushta me anëtarët e Këshillit për Investimet, institucionet shtetërore, komunitetin e biznesit dhe shoqërinë civile;
- Siguron qëndrueshmërinë në kohë dhe vijueshmërinë e Këshillit për Investimet;
- Në bashkëpunim me aparatin e shtypit të Qeverisë, informon publikun për aktivitetin e Këshillit për Investimet.

Pas diskutimeve të bëra në Këshillin për Investimet, Kryeministri merr vendimet zyrtare (në formën e udhëzimeve dhe vendimeve), të cilat u drejtohen institucioneve në vartësi të Qeverisë në lidhje me masa të veçanta dhe konkrete.

### **5. Rendi i ditës i mbledhjeve**

Procesi i vendosjes së rendit të ditës të mbledhjeve të Këshillit për Investimet kanë rëndësi të madhe përfshirë se punës të Këshillit për Investimet për të siguruar që ndërhyrjet të jenë të formuluara e të përgatitura mirë dhe të mund të arrijnë efektin maksimal. Sekretariati i Këshillit për Investimet, në bashkëpunim me Kryeministrinë, anëtarët e Këshillit dhe Sekretariatin e Këshillit Ekonomik Kombëtar, do të përcaktojë një rend dite të kufizuar me tema specifike, me synim arritjen e efektit maksimal.

Rendi i ditës i mbledhjeve të Këshillit për Investimet shpallet paraprakisht dhe u njoftohet të gjithë anëtarëve dhe palëve të tjera përkatëse.

Rendi i ditës mund të përfshijë seancat teknike të përqendruara tek objekti specifik, në bazë të një vendimi apo nisme të Këshillit për Investimet, me objektiv përgatitjen e rekomandimeve të qarta nga ekspertët se si të nxiten investimet dhe si të çohet përpëra procesi i reformave. Në seancat teknike angazhohen ekspertë të pavarur të fushës nga institucionet shtetërore, përfaqësues të shoqatave të biznesit dhe/ose përfaqësues të organizatave donatore.

### **6. Objektivat kryesore**

Këshilli për Investimet, nën orientimin e Kryeministrat dhe programit të reformave të Qeverisë, dhe me kontributet e përfaqësuesve të biznesit dhe analizës së pavarur të mjesdit të biznesit, do të përcaktojë një grup prioritete, në bazë të prioritetave të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, për çdo vit të ekzistencës së Këshillit.